



IDEA TEL sh.p.k.



Nr. 164 Prot.

Tiranë, më 19.09.2018

**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE
SHOQËRIA "IDEA - TEL" SH.P.K.
ORTAKU I VETËM
VENDIM**

Për nevoja që lidhen me diversifikimin e aktiviteteve investuese, në kuadër të zgjerimit të portofolit të investimeve të shoqërisë, dhe realizimin e qëndrueshëm të treguesve të veprimtarisë ekonomiko-financiarë, asambleja e ortakëve të "IDEA – TEL" Shpk, me NIPT J72902830L, sot më datë 19.09.2018, zhvilloi mbledhjen e saj të zakonshme, me këtë rend dite:

1. Themelimin e një shoqërie të re SH.P.K. me ortak të vetëm shoqërinë "IDEA - TEL" Sh.p.k. sipas dhe në përputhje me ligjin në fuqi për këtë qëllim.
2. Pjesëmarrjen e shoqërisë "IDEA – TEL" Sh.p.k. 100 % në kapitalin e shoqërisë së re.
3. Të tjera eventuale.

Të pranishëm në mbledhjen e asamblesë së përgjithshme të ortakëve të shoqërisë "IDEA – TEL" Sh.p.k.:

- **Z. Muhamer ÇIPI**, i biri Ramadan dhe Shqipërije, lindur në Ersekë dhe me banim në Tiranë, me adresë banimi Njësia Administrative Nr. 9, Rruga "Mine Peza", i datëlindjes 28.10.1964, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik Nr. 032900954 dhe Nr.Personal: G41028107H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.

Z. Muhamer ÇIPI është ortaku i vetëm i shoqërisë "IDEA – TEL" Sh.p.k. shoqëri e regjistruar pranë QKB – së me status aktiv dhe e identifikuar nëpërmjet NIPT: J72902830L.

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar, Ligjin Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit", si dhe në statutin e shoqërisë si dhe në aktin e themelimit të shoqërisë "IDEA – TEL" Sh.p.k.

V E N D O S A

1. Krijimin e shoqërisë së re "**Agrotech Farm**" Sh.p.k, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me objekt të **aktivitetit tregtarë në fushën e buqësisë, agro turizmit, tregëtimit të produkteve dhe pajisjeve buqësore, agroindustriale**, me kuotë pjesëmarrëse në kapital e shoqërisë tërësisht ose **100% prej shoqërisë "Idea - Tel" Sh.p.k., kapital i përbërë prej 1 Kuote** e cila përfaqëson 100 % kapitalin e shoqërisë dhe që zotërohet nga shoqëria "IDEA – TEL" Sh.p.k.




IDEA TEL sh.p.k.

2. Emërimin e **Z. Armand KAJA** i datëlindjes 03.05.1973, i identifikuar nëpërmjet pasaportës biometrike Shqiptare Nr. BG6591156 dhe Nr.Personal: H30503221F, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar në postin e Administratorit të vetëm të shoqërisë së re që do të formohet sipas këtij vendimi “Agrotech Farm” Sh.p.k. për një periudhë pesë vjeçare nga regjistrimi i shoqërisë së re “Agrotech Farm” Sh.p.k. pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKB-së).
3. Selia e shoqërisë së re që do të krijohet rishtazi “Agrotech Farm” Sh.p.k. është: **“Njësia Administrative Nr. 11, Tiranë, Rruga “Dritan Hoxha”, Ndërtesa Nr. 203, Hyrja Nr. 7, Apartamenti Nr. 27”**.
4. Miratohet statuti dhe akt themelimi i shoqërisë “Agrotech Farm” Sh.p.k. sipas modeleve bashkëlidhur këtij vendimi të cilat janë të nënshkruara nga unë ortak i vetëm i shoqërisë “IDEA – TEL” Sh.p.k si dhe nga administratori i ri i shoqërisë “Agrotech Farm” Sh.p.k. **Z. Armand KAJA**.
5. Autorizohet administratori i shoqërisë **Z. Genci MESI** të bëjë regjistrimin e këtij vendimi si në regjistrimin e shoqërisë “IDEA – TEL” Sh.p.k. ashtu edhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sipas ligjit në fuqi dhe brenda afateve ligjore.
6. Autorizohet administratori i shoqërisë **Z. Genci MESI** të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin dhe ekzekutimin e këtij vendimi.
7. Autorizohet administratori i zgjedhur **Z. Armand KAJA** të ndjek të gjitha procedurat e regjistrimit fillestar të shoqërisë së re “Agrotech Farm” Sh.p.k. dhe nëse do të jetë e nevojshme autorizohet administratori **Z. Genci MESI** ti jap prokurë të posaçme përfaqësimit **Z. Armand KAJA** për regjistrimin për herë të parë pranë QKB të shoqërisë së re “Agrotech Farm” Sh.p.k. sipas statutit dhe aktit të themelimit bashkëlidhur këtij vendimi.
8. **Ky vendim miratohet dhe hynë në fuqi sot më datë 19.09.2018.**

**SHOQËRIA “IDEA - TEL” SH.P.K.
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE
ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

Z. Muhamer Sipi



(nënshkrim)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTER ARDIAN STAMO
PERSON FIZIK L617240350
NR. 1042 . REP.



Taks. e Pullës
u Pagua

Tiranë më datë 19.09.2018

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot më datë 19.09.2018, para meje noterit të Dhomës së Notersë Tiranë, Noter Arrian STAMO, me zyrë të ndodhur në Tiranë, me adresë Rruga "Asim Vokshi", Pallati Nr. 141, u paraqit personalisht:-----

1. **Z. Muhamer ÇIPI**, i biri Ramadan dhe Shqipërije, lindur në Ersekë dhe me banim në Tiranë, me adresë banimi Njësia Administrative Nr. 9, Rruga "Mine Peza", i datëlindjes 28.10.1964, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik Nr. 032900954 dhe Nr.Personal: G41028107H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.-----

I sipërpërmendurit dhe në cilësin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" Sh.p.k. u paraqitën përpara meje noterit duke deklaruar se jashtë kësaj zyre noteriale ka hartuar vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" Sh.p.k. datë 19.09.2018 të cilën e nënshkruan në prani të noterit në çdo faqe personalisht. I sipërpërmendurit dhe në cilësin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" Sh.p.k. kërkoi nga unë noteri vërtetimin e nënshkrimit sipas dhe në përputhje me ligjin Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" i ndryshuar.-----

Z. Muhamer Çipi

(KËRKUESI)

Në përputhje me ligjin Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterin" i ndryshuar unë Noteri Arrian GJ. STAMO lëshoj këtë vërtetim nënshkrimi sipas ligjit në fuqi duke vërtetuar se dokumenti vendimi i ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" Sh.p.k. datë 19.09.2018 është nënshkruar përpara meje noterit nga Z. Muhamer ÇIPI i identifikuar si më sipër dhe në cilësin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA - TEL" Sh.p.k. datë 19.09.2018. Ky vërtetim nënshkrimi i bashkëlidhet aktit të nënshkruar nga kërkuesi në prani të noterit.-----

NOTER

Arrian Stamo
1



AKTI I THEMELIT

NENI 1 FORMA E SHOQËRISË

Sipas vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" SH.P.K. formohet një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SH.P.K), që ushtron aktivitetin e saj sipas objektit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe në veçanti, por jo ekskluzivisht, me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar, me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" të ndryshuar, Ligjin Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" si dhe me përcaktimet e këtij akt themelimi si dhe me statutin e cila zotërohet 100 % nga shoqëria "IDEA – TEL" SH.P.K..

NENI 2 EMRI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë është "AGROTECH FARM" SH.P.K. Shoqëria mund të përdor edhe emërtimin e saj tregtar "AGROTECH" SH.P.K. Shoqëria do të përdorë edhe vulën e saj në të gjitha korrespondencat dhe/ose në të gjitha dokumentet e saj e cila do të përbëhet minimalisht nga emri i shoqërisë dhe nga NIPT dhe nga çdo karakteristikë tjetër e nevojshme për shoqërinë.

NENI 3 ORTAKËT E SHOQËRISË

Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K. krijohet dhe themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 1 (një) ortak të vetëm. Ortaku i shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K. është Shoqëria "IDEA – TEL" SH.P.K. shoqëri me status aktiv dhe e identifikuar nëpërmjet NIPT: J72902830L sipas dhe në përputhje me vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" SH.P.K. datë 11.09.2018. Shoqëria "IDEA – TEL" SH.P.K. është shoqërie e cila është e themeluar më datë 11.12..1997, shoqëri e regjistruar pranë QKB –së, shoqëri me status aktiv, shoqëri me seli të ndodhur në Tiranë, Rruga "Dritan Hoxha", Ndërtesa Nr. 203, Hyrja Nr. 7, Apartamenti Nr. 27. Shoqëria sipas vendimarrjes së ortakut të vetëm të shoqërisë ose sipas vendimit të Asambles së Përgjithshme të Ortakëve dhe sipas rregullave/procedurave të këtij akt themeli, statutit të shoqërisë si dhe dispozitave ligjore në fuqi mund të bëhet shoqëri me më shumë se një ortak. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëhere ortakut i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortakut i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëhere ortakut përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsiper nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

NENI 4 SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K ndodhet me adresë: "Njësia Administrative Nr. 11, Tiranë, Rruga "Dritan Hoxha", Ndërtesa Nr. 203, Hyrja Nr. 7, Apartamenti Nr. 27". Trasferimi i selisë së shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K në një tjetër adresë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve (ortakut të vetëm) dhe sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim duke bërë regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe duke bërë njoftimet e tjera sipas legjislacionit në fuqi



(administratën tatimore qendrore dhe vendore). Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K mund të vendos të hapi brenda dhe jashtë vendit, degë dhe/ose zyra përfaqësimit sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi duke bërë regjistrimet e nevojshme sipas legjislacionit shqiptarë dhe/ose të huaj në fuqi për këtë qëllim.

NENI 5 OBJEKTI / VEPRIMTARIA TREGTARE E SHOQËRISË

Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K ka si objekt të veprimtarisë tregtare së saj, por pa u kufizuar, si vijon: **"aktivitetit tregtarë në fushën e buqësisë, në fushën e blektorisë, në fushën e agro turizmit, në fushën e tregëtimit të produkteve dhe/ose pajisjeve buqësore e agroindustriale, etj"**. Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K mund gjithashtu të blejë dhe të shesë pasuri të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, të kryejë çdo lloj operacioni financiar aktiv e pasiv, të ndërmarrë e të zhvillojë çdo lloj aktiviteti industrial, tregtar, që konsiderohen të dobishme dhe të përshtatshme si dhe fitimprurëse për shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptarë në fuqi dhe/ose me legjislacionin e huaj për këtë qëllim. Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K dhe sipas interesit të ortakut dhe/ose ortakëve të saj mund të ushtroje aktivitet tregtar fitimprurës të tjera nga ajo e përcaktuar në këtë neni, duke respektuar paraprakisht çdo kërkesë ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim. Për aktivitet e përmendura më sipër shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K (si dhe ato të papërmendura dhe të lejuara në bazë të legjislacionit në fuqi) mund ti kryej në sektorin publik, të administrimit publik në përgjithësi si dhe në sektorin privat. Aktivitete të tilla mund të kryhen nga shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K, si drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet subjekteve të treta me qëllimet e dhëna, ose pjesëmarrëse ose të kontrolluar. Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve (ortakut të vetëm), në bazë të dispozitave të aktit të themelimit, statutit dhe në përputhje me ligjin/legjislacionin në fuqi, mund të marrë drejtpërdrejtë ose indirekt interesa ose pjesëmarrje, duke përfshirë edhe ato aksionare, në shoqëri dhe/ose në ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri dhe/ose në vende të tjera jashtë Shqipërisë, që kanë objekt të ngjashëm, të njëjtë ose kanë lidhje me objektin e saj ose me qëllim fitimprurëse për shoqërinë. Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K nuk ka për të kryer asnjë aktivitet pa marrë paraprakisht licencat e nevojshme sipas legjislacionit shqiptarë në fuqi apo legjislacionit të shteteve të huaja ku mund të ushtrojë aktivitetin e saj.

NENI 6 KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K është e pakufizuar. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K fillon nga data e regjistrimit në regjistrin tregëtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) / Biznesit (QKB) dhe nëse kërkohet nga ligji mbas marrjes së licencave përkatëse për ushtrimin e aktivitetit tregtar.

NENI 7 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali bazë fillestar i shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K është **1.000 (njëmijë) lek** dhe tërësisht i paguar nga ortaku i vetëm i shoqërie sipas pjesmarrjes në kapital e shoqërisë. Kontributi i ortakut/ëve përbëjnë kapitalin themelitarë dhe të regjistruar të shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K. Kapitali shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K përbëhet nga 1 kuotë e cila ka vlerën / përfaqëson 100 % kapitalin e shoqërisë.

 2

NENI 8 KONTRIBUTET NË KAPITALIN BAZË / FILLESTAR TË SHOQËRISË

Kapitali bazë përbëhet nga kontributi i ortakut/ëve si vijon: Shoqëria "IDEA – TEL" SH.P.K. është shoqërie e themeluar më datë 11.12.1997, shoqëri e regjistruar pranë QKB –së, shoqëri me status aktiv, shoqëri e identifikuar me NIPT: J72902830L, shoqëri me seli të ndodhur në Tiranë, Rruga "Dritan Hoxha", Ndërtesa Nr. 203, Hyrja Nr. 7, Apartamenti Nr. 27 e cila kontribon 100 % duke zotëruar 100 % kapitalin e shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K, ose duke zotëruar 100 % kuotën e vetme në kapitalin e shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K e cila përbën / përfaqëson 100 % kapitalin e shoqërisë. Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë e cila provon zotërimin e kuotave të kapitalit nga ortakut/ët e saj sipas dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim. Administratori dhe sipas nevojës mund të marrë vërtetim mbi statusin e kuotave të shoqërisë pranë Regjistrimit të Barrave të Sigurimit (RBS) dhe/ose çdo institucion tjetër kompetent për këtë qëllim sipas dhe në përputhje me ligjin në fuqi për këtë qëllim. Certifikata e lëshuar sipas pikës 2 të këtij neni në emër të personit ose personave që zotërojnë kuotat në këtë shoqëri nuk mund të konsiderohet titull/letër me vlerë dhe/ose të vendoset si garanci. Të gjithë pjesët që formojnë kapitalin themeltar, nënshkruhen, shlyhen plotësisht, nga ortakut/ët e shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K.

NENI 9 ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

Organet e shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K janë si më poshtë vijon: Asambleja e Përgjithshme; Administratori/et.

NENI 10 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË


Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K. administrohet nga administratori i vetëm **Z. Armand KAJA** i datëlindjes 03.05.1973, i identifikuar nëpërmjet pasaportës biometrike Shqiptare Nr. BG6591156 dhe Nr.Personal: H30503221F, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar. Shoqëria mund të ketë më shumë se një administrator kur vendoset nga Ortaku i vetëm ose nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K. dhe regjistrohet si i tillë pranë QKB.Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të dministratorëve në masën e përshtatshme. Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të pushimit të papritur. Administratori emerohet në këtë detyrë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare. Kontrata e punës së administratorit dhe kur administratori është i ndryshëm nga ortakut i vetëm i shoqërisë duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Rruga e administratorit të shoqërisë caktohet në kontratën e punës. Administratori ka të drejta dhe detyrime si më poshtë citohet në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me këtë akt themelimi dhe/ose statut: kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme; përfaqëson shoqërinë tregtare; kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë; përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor,



bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim; krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë; kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit; raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare; kryerjen e detyrave të tjera që i caktohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim. Administratori është përgjegjës kundër shoqërisë ose të tretëve, si për shkelje të ligjit, ashtu edhe për shkelje të statutit ose për faje të kryera gjatë administrimit të tij. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblesën e Përgjithshme të Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën doreheqja të hyjë në fuqi. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji. Emërimi i administratorit/rëve të ri/rinjë, hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

NENI 11 PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit/ëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Administratori/ët, që përfaqësonjnë bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës



Kombëtare të Regjistrimit. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme: numrin unik të identifikimit; formën ligjore të shoqërisë; vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj; të dhëna nëse shoqëria është në likuidim; Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

NENI 12

Cdo gjë që tjetër dhe/ose më e detajuar parashikohet në statutin e shoqërisë, dhe/ose në legjislacionin shqiptarë në fuqi për këtë qëllim, kopje e të cilit do të depozitohet në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (Q.K.R) / Biznesit (Q.K.B) me qëllim jo vetëm regjistrimi.

THEMELUESI I SHOQËRISË “AGROTECH FARM” SH.P.K.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË “IDEA - TEL” SH.P.K.

Z. Mohamor Gipi

(nënshkrimi)

Z. [Signature]

(nënshkrimi)

DATE 19 .09.2018.



STATUTI

KREU I THEMELIMI, EMËRTIMI, SELIA, OBJEKTI, REGJISTRIMI, REGJIMI, ORTAKËT DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË NENI 1 THEMELIMI I SHOQËRISË

Sipas vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë “**IDEA – TEL**” SH.P.K. formohet një shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (**SH.P.K.**), që ushtron aktivitetin e saj sipas objektit në përputhje me Legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe në veçanti, por jo ekskluzivisht, me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” të ndryshuar, Ligjin Nr.131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” si dhe me përcaktimet e këtij akt themelimi si dhe me statutin e cila zotërohet 100 % nga shoqëria “**IDEA – TEL**” SH.P.K..

NENI 2 EMËRTIMI I SHOQËRISË

Emri i shoqërisë është “**AGROTECH FARM**” SH.P.K. Shoqëria mund të përdor edhe emërtimin e saj tregtar “**AGROTECH**” SH.P.K. Shoqëria do të përdorë edhe vulën e saj në të gjitha korrespondencat dhe/ose në të gjitha dokumentet e saj e cila do të përbëhet minimalisht nga emri i shoqërisë dhe nga NIPT dhe nga çdo karakteristikë tjetër e nevojshme për shoqërinë.

NENI 3 SELIA E SHOQËRISË

Selia e shoqërisë “**AGROTECH FARM**” SH.P.K. ndodhet me adresë: **Njësia Administrative Nr. 11, Tiranë, Rruga “Dritan Hoxha”, Ndërtesa Nr. 203, Hyrja Nr. 7, Apartamenti Nr. 27**. Trasferimi i selisë së shoqërisë “**AGROTECH FARM**” SH.P.K. në një tjetër adresë bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve (ortakut të vetëm) dhe sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim duke bërë regjistrimin pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit si dhe duke bërë njoftimet e tjera sipas legjislacionit në fuqi (administratën tatimore qendrore dhe vendore). Shoqëria “**AGROTECH FARM**” SH.P.K. mund të vendos të hapi brenda dhe jashtë vendit, degë dhe/ose zyra përfaqësimit sipas procedurave ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi duke bërë regjistrimet e nevojshme sipas legjislacionit shqiptarë dhe/ose të huaj në fuqi për këtë qëllim.

NENI 4 OBJEKTI / VEPRIMTARIA TREGTARE E SHOQËRISË

Shoqëria “**AGROTECH FARM**” SH.P.K. ka si objekt të veprimtarisë tregtare së saj, por pa u kufizuar, si vijon: “**aktivitetit tregtarë në fushën e buqësisë, në fushën e blektorisë, në fushën e agro turizmit, në fushën e tregëtimit të produkteve dhe/ose pajisjeve buqësore e agroindustriale, etj**”. Për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, shoqëria “**AGROTECH FARM**” SH.P.K mund gjithashtu të blejë dhe të shesë pasuri të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, të kryejë çdo lloj operacioni financiar aktiv e pasiv, të ndër marrë e të zhvillojë çdo lloj aktiviteti industrial, tregtar, që konsiderohen të dobishme dhe të përshtatshme si dhe fitimprurëse për shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptarë në fuqi dhe/ose me legjislacionin e huaj për këtë qëllim. Shoqëria “**AGROTECH FARM**” SH.P.K dhe sipas interesit të ortakut dhe/ose ortakëve të saj mund të ushtroje aktivitet tregtar fitimprurës të tjera nga ajo e

përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, duke respektuar paraprakisht çdo kërkesë ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi për këtë qëllim. Për aktivitetet e përmendura shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K (si dhe ato të papërmendura dhe të lejuara në bazë të legjislacionit në fuqi) mund të kryejnë në sektorin publik, të administrimit publik në përgjithësi si dhe në sektorin privat. Aktivitete të tilla mund të kryhen nga shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K si drejtpërdrejtë dhe nëpërmjet subjekteve të treta me qëllimet e dhëna, ose pjesëmarrëse ose të kontrolluar. Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve (ortakut të vetëm), në bazë të dispozitave të aktit të themelimit, statutit dhe në përputhje me ligjin/legjislacionin në fuqi, mund të marrë drejtpërdrejtë ose indirekt interesa ose pjesëmarrje, duke përfshirë edhe ato aksionare, në shoqëri dhe/ose në ndërmarrje të ndryshme në Shqipëri dhe/ose në vende të tjera jashtë Shqipërisë, që kanë objekt të ngjashëm, të njëjtë ose kanë lidhje me objektin e saj ose me qëllim fitimprurës për shoqërinë. Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K nuk kapër të kryer asnjë aktivitet pa marrë paraprakisht licencat e nevojshme sipas legjislacionit shqiptarë në fuqi apo legjislacionit të shteteve të huaja ku mund të ushtrojë aktivitetin e saj.

NENI 5 REGJISTRIMI

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "AGROTECH FARM" SH.P.K formohet sipas vendimit të ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" SH.P.K. si shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K) në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar dhe që zotërohet 100 % nga shoqëria "IDEA – TEL" SH.P.K. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "AGROTECH FARM" SH.P.K regjistrohet sipas Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Qendra Kombëtare e Regjistrimit" i ndryshuar si dhe me Ligjin Nr.131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit". Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K duhet të regjistrojë dhe të arkivojë dokumentet në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Qendra Kombëtare e Regjistrimit" i ndryshuar si dhe me ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Nëse shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K do të ketë faqen e saj interneti të dhënat e nevojshme që do ti njoftohen QKR-së për regjistrim do të publikohen dhe do ti vihen në dispozicion edhe personave të tretë të interesuar.

NENI 6 REGJIMI JURIDIK I SHOQËRISË

Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut të lirë, me objektiv për të nxjerrë fitim. Aktiviteti i saj bazohet në statutin dhe në aktin e themelimit të shoqërisë, si dhe me legjislacionin shqiptar në fuqi. Shoqëria ka personalitet juridik i cili fillon që nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR).

NENI 7 ORTAKËT E SHOQËRISË

Shoqëria "AGROTECH FARM" SH.P.K krijohet dhe themelohet si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me 1 (një) ortak të vetëm. Ortaku i shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K është: Shoqëria "IDEA – TEL" SH.P.K. shoqëri me status aktiv dhe e identifikuar nëpërmjet NIPT: J72902830L sipas dhe në përputhje me vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" SH.P.K. datë 11.09.2018. Shoqëria "IDEA – TEL" SH.P.K. është shoqërie e cila është e themeluar më datë 11.12..1997, shoqëri e regjistruar pranë QKB –së, shoqëri me status aktiv, shoqëri me seli të ndodhur në Tiranë, Rruga "Dritan Hoxha", Ndërtesa

Nr. 203, Hyrja Nr. 7, Apartamenti Nr. 27. Shoqëria sipas vendimarrjes së ortakut të vetë të shoqërisë ose sipas vendimit të Asambles së Përgjithshme të Ortakëve dhe sipas rregullave/procedurave të këtij akt themeli, statutit të shoqërisë si dhe dispozitave ligjore në fuqi mund të bëhet shoqëri me më shumë se një ortak. Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëhere ortakut i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortakut i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëhere ortakut përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsiper nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

NENI 8 KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K është e pakufizuar. Kohëzgjatja e aktivitetit/veprimtarisë të shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K fillon nga data e regjistrimit në regjistrin tregëtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR) / Biznesit (QKB) dhe nëse kërkohet nga ligji mbas marrjes së licencave përkatëse për ushtrimin e aktivitetit tregëtar.

KREU II KAPITALI I SHOQËRISË NENI 9 KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali bazë fillestar i shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K është **1.000 (njëmijë) lek** dhe tërësisht i paguar nga ortakut i vetëm i shoqërisë sipas pjesmarrjes në kapital e shoqërisë. Kontributi i ortakut/ëve përbëjnë kapitalin themelues dhe të regjistruar të shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K Kapitali shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K përbëhet nga 1 kuotë e cila ka vlerën / përfaqëson 100 % kapitalin e shoqërisë.

NENI 10 KONTRIBUTET NË KAPITALIN BAZË / FILLESTAR TË SHOQËRISË

Kapitali bazë përbëhet nga kontributi i ortakut/ëve si vijon: Shoqëria "IDEA – TEL" SH.P.K. shoqëri me status aktiv dhe e identifikuar nëpërmjet NIPT: J72902830L sipas dhe në përputhje me vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" SH.P.K. datë 11.09.2018. Shoqëria "IDEA – TEL" SH.P.K. është shoqërie e cila është e themeluar më datë 11.12..1997, shoqëri e regjistruar pranë QKB –së, shoqëri me status aktiv, shoqëri me seli të ndodhur në Tiranë, Rruga "Dritan Hoxha", Ndërtesa Nr. 203, Hyrja Nr. 7, Apartamenti Nr. 27. Shoqëria mund të lëshojë një certifikatë e cila provon zotërimin e kuotave të kapitalit nga ortakut/ët e saj sipas dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim. Administratori dhe sipas nevojës mund të marrë vërtetim mbi statusin e kuotave të shoqërisë pranë Regjistrimit të Barrave të Sigurimit (RBS) dhe/ose çdo institucion tjetër kompetent për këtë qëllim sipas dhe në përputhje me ligjin në fuqi për këtë qëllim. Certifikata e lëshuar sipas pikës 2 të këtij neni në emër të personit ose personave që zotërojnë kuotat në këtë shoqëri nuk mund të konsiderohet titull/letër me vlerë dhe/ose të vendoset si garanci. Të gjithë pjesët që formojnë kapitalin themelues, nënshkruhen, shlyhen plotësisht, nga ortakut/ët e shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K.

NENI 11 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT BAZË



Pjesët e kapitalit bazë/kuotat, mund të transferohen lirisht në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe me përcaktimet e këtij statuti. Kalimi i kuotave kushtëzohet nga miratimi i Asamblesë së Përgjithshme si dhe nga e drejta e parablerjes në favor të ortakëve. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim sipas procedurave dhe dispozitave ligjore në fuqi për këtë qëllim dhe me akt noterial. Në rastet e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotën, si dhe kushtet e tjera të kalimit, përfshirë momentin e pagesës së çmimit, rregullohen nga kontrata. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palët bien dakord në kontratë, vlefshmëria e kalimit të titullit të pronësisë mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ, përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit, sipas pikës 2 të këtij neni. Shoqëria regjistron kalimin e kuotës, sipas nenit 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ. Me përjashtim të rasteve kur kjo është e ndaluar nga statuti, kuotat mund të pjesëtohen për shkak të kalimit të tyre. Dispozitat e nenit 73 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar për kalimin e kuotave zbatohen edhe për kalimin e pjesëve të kuotave.

NENI 12 ABUZIMI I ORTAKËVE

Ortaku dhe/ose ortakët e shoqërisë, që kryejnë një ose më shumë prej veprimeve të mëposhtme, janë personalisht përgjegjës për detyrimet e shoqërisë, me të gjitha pasuritë e tyre: abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare për arritjen e qëllimeve të paligjshme; trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishin pasuritë e tyre; nuk njoftojnë në kohë problemet e shoqërisë (si, njoftimet mbi aftësinë paguese të shoqërisë ose të gjitha problemet e tjera që rrezikojnë atë, etj).

NENI 13 NDALIMI I KONKURENCËS DHE SEKRETI TREGTAR

Ortakët nuk mund të mbajnë pozicione drejtuese apo të jenë të punësuar në shoqëri të tjera, që ushtrojnë veprimtari në të njëjtin sektor ekonomik që ushtrojnë me këtë shoqëri në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ndalimi i përmendur me sipër mund të anulohet në vijim të një autorizimi të lëshuar nga Asambleja e Përgjithshme me 3/4 e votave të ortakëve. Nëse një nga ortakët dhunon ndalimin e konkurrencës, shoqëria, ka të drejtë: ta përjashtojë atë nga shoqëria apo ta shkarkojë nga detyra; të kërkojë ndërprerjen e veprimtarisë konkurruese; të ngrejë padi për shpërblimin e dëmit. Etj sipas ligjit në fuqi. Të gjithë personat e kësaj shoqërie, të cilët janë në dijeni të sekretit tregtar të kësaj shoqërie janë personalisht përgjegjës për ruajtjen e tij në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Zbatueshmëria e përcaktimeve të këtij neni është në përpjestim të drejtë dhe për aq sa lidhet me faktin e shoqërisë me ortak të vetëm.

NENI 14 SHKARKIM I ORTAKTUT TË SHOQËRISË

Ortaku mund të largohet nga shoqëria nëse ortakët e tjerë ose shoqëria kanë kryer veprime në dëm të tij, nëse është penguar të ushtrojë të drejtat e tij, nëse shoqëria i ka ngarkuar detyrime të paarsyeshme apo për shkaqe të tjera, që e bëjnë të pamundur vazhdimin e ortakërisë. Ortaku që kërkon largimin, duhet të njoftojë shoqërinë me shkrim, si dhe të parashtojë shkaqet e largimit. Administratori duhet të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, mbasi ka marrë lajmërimin e thene

më sipër, për të vendosur nëse kuota e këtij ortakut do të likujdohet, për shkak të largimit të tij nga shoqëria. Ortaku ka të drejtë të ngrejë padi në gjykatë ndaj shoqërisë për likuidimin e kuotës, si pasojë e largimit për shkaqe të arsyeshme, nëse pas njoftimit të largimit Asambleja e Përgjithshme nuk mblidhet apo nuk njuh si të arsyeshme shkaqet e largimit dhe likuidimin e kuotës. Ortaku që kërkon largimin nga shoqëria, detyrohet ta dëmshpërblejë shoqërinë për dëmet e shkaktuara. Zbatueshmëria e këtij neni do të lidhet me kohën kur shoqëria do të ketë më shumë se një ortak.

NENI 15 PËRJASHTIMI I NJË ORTAKU

Në bazë të një vendimi të zakonshëm, Asambleja e Përgjithshme mund t'i kërkojë gjykatës përjashtimin e ortakut, nëse ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve të statutit ose nëse ekzistojnë shkaqe të tjera të arsyeshme për këtë përjashtim. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme për përjashtimin e ortakut, sipas pikës 1 të këtij neni, por pa u kufizuar në to, rastet kur ortakut: me dashje apo me pakujdesi të rëndë i shkakton dëme shoqërisë ose ortakëve të tjerë; me dashje apo me pakujdesi të rëndë shkel statutin ose detyrimet e përcaktuara me ligj; përfshihet në veprime, të cilat e bëjnë të pamundur vazhdimin e marrëdhënieve midis shoqërisë tregtare dhe ortakut, ose; me veprimet e tij dëmton ose pengon ndjeshëm veprimtarinë tregtare të shoqërisë. Shoqëria, ka të drejtë ti kërkojë ortakut të përjashtuar, dëmshpërblimin e dëmeve që ka pasur nga veprimet që kanë shkaktuar përjashtimin. Ortaku ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë shpërblimin e dëmit të pësuar, nëse kërkesa për përjashtim nuk është e bazuar. Ortaku nuk ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë likuidimin e kuotës, nëse ai përjashtohet për shkaqe të arsyeshme, por, nëse shoqëria ngre ndaj tij padi për shpërblim dëmi, ortakut ka të drejtë të kompensojë çdo shumë, që do të kishte të drejtë ta përfitonte në cilësinë e likuidimit të kuotës, me dëmin e kërkuar nga shoqëria. Zbatueshmëria e këtij neni do të lidhet me kohën kur shoqëria do të ketë më shumë se një ortak.

NENI 16 SHPËRNDARJA, KUFIZIM I SHPËRNDARJES DHE CERTIFIKATA E AFTËSISË PAGUESE

Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë merr vendim për shpërndarjen e fitimeve në përputhje me përcaktimet e këtij statuti dhe/ose ligjit në fuqi. Përfitimet e shoqërisë ndahen sipas balanceve financiare të shoqërisë. Shoqëria mund t'u shpërndajë fitime, vetëm nëse pas pagimit të dividendit: aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj; shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim Administratori përgjigjet ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës së aftësisë paguese sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. Ortaku, që ka marrë nga shoqëria dividendë, përgjigjet personalisht ndaj shoqërisë për kthimin e dividendit, që ka shpërndarë kur nuk është lëshuar certifikata e aftësisë paguese, ose kur ka pasur dijeni ndaj paaftësisë paguese të shoqërisë

NENI 17 ANULLIMI I KUOTAVE NGA SHOQËRIA

Shoqëria ka të drejtë për të anuluar një kuotë. Shkaqet si dhe procedurat e anulimit dhe likuidimit të kuotës parashikohen në vendimi e marrë nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Të drejtat e detyrimet, që i rrjedhin ortakut nga zotërimi i kuotës, shuhet me anulimin e saj sipas pikës 2 të këtij neni.



KREU III ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE TË SHOQËRISË NENI 18 ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K janë si vijon: **Asambleja e Përgjithshme; Administratori/ët.** Ky statut apo çdo vendim i shoqërisë nuk mund të ndryshojë apo të kufizojë kompetencat që ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar përcakton për organet e shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K përcaktuar në pikën 1 të këtij neni. Statuti, akti i themelimit apo vendimet e shoqërisë nuk mund të ndryshojnë apo të kufizojnë kompetencat ligj ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar përcakton për organet e shoqërisë tregtare. Çdo veprim, që ka për qëllim ndryshimin apo kufizimin e kompetencave të organeve të shoqërisë, të cilat nuk lejohen shprehimisht, sipas këtij ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, nuk mund t'u kundrejtohen palëve të treta edhe nëse janë bërë publike në statut apo sipas mënyrave të parashikuara nga ligji Nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar.

NENI 19 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

1. Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) transferimin e kuotave të shoqërisë;
 - d) emërimin e shkarkimin e administratorëve si dhe caktimin e shpërblimit të tij;
 - e) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - f) përcaktimin e shpërblimeve të likuiduesit dhe të ekspertëve kontabel;
 - g) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - i) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - j) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - k) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - l) shpërndarjen e fitimeve;
 - m) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - n) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
2. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "g" dhe "i" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
3. Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.
4. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
 - a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;



- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
5. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.
6. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

NENI 20 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligj Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nga administratori/ët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligjit Nr. 9901, data 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve thirret të paktën një herë në vit. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktivet e shoqërisë të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

NENI 21 Mënyra e Thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori dhe/ose nga ortakut/ortakët nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

NENI 22 Kërkesa nga Ortakët e Pakicës

1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur Asamblenë e Përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim.
2. Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:



- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
 - b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.
3. Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës.

NENI 23 PËRFAQËSIMI NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME

Ortaku mund të përfaqësohet në Asambleshën e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi me shkrim nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në Asambleshën e Përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesës së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesës së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

NENI 24 KUORUMI

1. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë **shumicë të kualifikuar**, sipas nenit 25 të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve nenit 26 të këtij statuti.
2. Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë një **shumicë të zakonshme**, sipas nenit 25 të këtij statuti, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve nenit 26 të këtij statuti.
3. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 dhe/ose pikën 2 të këtij neni, Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
4. Deris sa shoqëri të jetë me një ortak këto vendime merren nga ortaku i vetëm sipa dispozitave të këtij statuti si dhe sipas kërkesave ligjore në fuqi

NENI 25 MARRJA E VENDIMEVE

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (**shumica e kualifikuar**) për çështjet e përcaktuara në nenin 19, shkronja "b", shkronja "i", shkronja "l", shkronja "m".
2. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve vendos me shumicën e votave të ortakëve (**shumica e zakonshme**) pjesëmarrës për të gjithë çështjet e tjera të përcaktuara në nenin 19 të këtij statuti.
3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.
4. Përcaktimet e pikës 1 deri tek pika 3 e këtij neni do të zbatohen kur shoqëria do të bëhet me më shumë se një ortak, deriatëhere vendimet merren nga ortaku i vetëm.



NENI 26 E DREJTA E VOTËS

Çdo kuotë jep të drejtën e një vote. Çdo ortak ka të drejtë vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotës së tij. Lejohet pjesëmarrjes në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve me mjete të ndryshme komunikimi, përfshirë mjetet elektronike, me kusht që të garantohet identifikimi i ortakëve. Mjetet elektronike përfshijnë, por pa u kufizuar në to: transmetimin e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në kohë reale; komunikimin e ndërsjellë në kohë reale, i cili u mundëson ortakëve të shprehen për mbledhjen e asamblesë së përgjithshme nga një vendndodhje tjetër; mekanizma, që mundësojnë procesin e votimit, përpara apo gjatë mbajtjes së mbledhjes së asamblesë së përgjithshme, pa qenë nevoja të caktohet një përfaqësues i autorizuar, për të marrë pjesë fizikisht në mbledhje. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në statut, çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

NENI 27 PROCESVERBALI I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal me numër dhe datë dhe/ose në format elektronik, kur shoqëria të bëhet me më shumë se një ortak. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

NENI 28 ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

1. Shoqëria “AGROTECH FARM” SH.P.K administrohet nga administratori i vetëm **Z. Armand KAJA** i datëlindjes **03.05.1973**, i identifikuar nëpërmjet pasaportës biometrike Shqiptare Nr. **BG6591156** dhe Nr. Personal: **H30503221F**, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.
2. Shoqëria mund të ketë më shumë se një administrator kur vendoset nga Ortaku i vetëm ose nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të shoqërisë “AGROTECH FARM” SH.P.K dhe regjistrohet si i tillë pranë QKB.
3. Shpërblimi i administratorit duhet të jetë i përshtatshëm dhe në përputhje me detyrat e administratorëve dhe gjendjen financiare të shoqërisë. Nëse shoqëria është në vështirësi financiare, Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të vendosë reduktimin e shpërblimit të administratorëve në masën e përshtatshme.
4. Ortaku i vetëm ose Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
5. Afati i emërimit, i cili caktohet në statut, nuk mund të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje, me përjashtim të rasteve të dorëheqjes ose të pushimit të papritur.

6. Administratori emerohet në këtë detyrë për një periudhë kohore 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Kontrata e punës së administratorit dhe kur administratori është i ndryshëm nga ortaku i vetëm i shoqërisë duhet të miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
7. Administratori ka të drejta dhe detyrime si më poshtë citohet në përputhje me ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me këtë akt themelimi dhe/ose statut:
- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
 - c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejn regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
 - g) raportojn përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryerjen e detyrave të tjera që i caktohen nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
 - i) Administratorit duhet të marrë miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për çdo veprim juridike apo kontratë të një anëshme apo të dyanëshme me palë të treta i cili ka vlerën mbi 3.000 (tre mijë) Euro apo kundërvleftën e saj në para Shqiptare.**
8. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
9. Administratori është përgjegjës kundër shoqërisë ose të tretëve, si për shkelje të ligjit, ashtu edhe për shkelje të stautit ose për fajet kryera gjatë administrimit të tij.
10. Administratori mund të heqë dorë në çdo kohë nga detyra e tij, nëpërmjet një njoftimi me shkrim drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve. Administratori, që jep dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së shoqërisë, është gjithashtu i detyruar të thërrasë Asamblesën e Përgjithshme të Ortakëve për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën doreheqja të hyjë në fuqi.
11. Nëse Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve nuk vendos emërimin e administratorit të ri në datën e përcaktuar në thirrjen e kryer nga administratori i dorëhequr, atëherë administratori i njofton me shkrim dorëheqjen Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me kopjen e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve dhe Qendra Kombëtare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Per Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
12. Dorëheqja e administratorit nuk cenon paditë e shoqërisë për shkelje të detyrimit të besnikërisë që administratori ka ndaj saj, sipas këtij ligji.

13. Emërimi i administratorit/rëve të ri/rinjë, hyn në fuqi në datën e përcaktuar sipas aktit të emërimit, u kundrejtohet palëve të treta sipas përcaktimeve të nenit 12 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

NENI 29 PËRFAQËSIMI I SHOQËRISË

1. Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit/ëve i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të ligji Nr. 9901, date 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqërisë tregtare” i ndryshuar.
2. Administratori, që përfaqëson një bashkërisht shoqërinë tregtare, mund të autorizojnë disa prej tyre për kryerjen e disa veprimeve të caktuara apo për kryerjen e disa kategorive të caktuara veprimesh.
3. Përfaqësimi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) është i vlefshëm për çdo veprim gjyqësor apo jashtëgjyqësor.
4. Veprimet e kryera nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë (i drejteperdrejte ose i deleguar me autorizim) janë të detyrueshme për shoqërinë edhe nëse këto tejkalojnë objektin e saj, me përjashtim të rastit kur këto veprime shkojnë përtej tagrave të përfaqësimit që u jep ligji apo lejon t'u jepen përfaqësuesve. Këto veprime nuk janë detyruese për shoqërinë nëse shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni se akti tejkalon objektin e saj, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të. Publikimi nëpërmjet ndryshimit të statutit nuk përbën provë të mjaftueshme për dijeninë e të tretëve, nëse ky ndryshim është bërë publik në mënyrë të ndryshme nga ato të parashikuara nga ligji për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
5. Njoftimet e drejtuara secilit prej administratorëve janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
6. Tagrat e përfaqësimit të administratorëve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
7. Të gjitha shkresat, formularët e urdhrave apo çdo dokument tjetër korrespondencë, nxjerrë nga shoqëria, degët apo zyrat e përfaqësimit, nëpërmjet përdorimit të letrës ose mjeteve elektronike, të cilat u drejtohen palëve të treta, duhet të përmbajnë të dhënat e mëposhtme:
 - a. numrin unik të identifikimit;
 - b. formën ligjore të shoqërisë;
 - c. vendndodhjen e selisë së regjistruar dhe të zyrës qendrore të saj;
 - d. të dhëna nëse shoqëria është në likuidim;
 - e. Nëse shoqëria ka faqe interneti, këto të dhëna duhet të pasqyrohen aty.

NENI 30 DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 28 dhe 29 të këtij statuti, administratori/ët detyrohet/n: të kryejnë detyrat të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis; të ushtrojnë kompetencat që u njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita; të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim; të parandalojnë dhe mënjanojnë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë; të garantojnë miratimin e marrëveshjeve sipas



dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji; të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori/ët, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
3. Nëse administratori/ët veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkelin standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojnë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratorët kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.
4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratorët janë të detyruar t'i dëmshpërblejnë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryejnë veprimet e mëposhtme: u kthejnë ortakëve kontributet u paguajnë ortakëve interesa apo dividendë; u shpërndajnë aktivet shoqërisë; lejojnë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet; japin kredi.
5. Asambleja e Përgjithshme dhe sipas përcaktimve ligjore dhe/ose sipas këtij statuti mund të ngrejë padi përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe/ose gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorit si pasojë e shkeljeve të rënda të ligjit dhe/ose dispozitave të këtij statuti dhe/ose padi të tjera që parashikon ligji në fuqi.
6. Ortakët të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në asamblenë e shoqërisë dhe/ose kreditorët e shoqërisë të cilët pretendojnë se shoqëria ka ndaj tyre detyrim në një vlerë jo më të vogël se 5 % e kapitalit të shoqërisë, mund të kërkojnë Asamblesë së Shoqërisë ngritjen e padisë për shfuqizimin e vendimeve të administratorit, nëse kjo kërkesë nuk procedohet nga ky organ i shoqërisë brenda 60 ditëve nga njoftimi atëhere kjo kërkesë konsiderohet e rrëzuar. Në rast refuzimi të kërkesës dhe brenda 30 ditëve ortakët apo kreditorët e shoqërisë mund ta ngrenë këtë padi drejtë për drejtë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ose në çdo gjykatë kompetente.

KREU IV VITI FINANCAR DHE EKSPERTI NENI 31 VITI USHTRIMOR, LLOGARI VJETORE

Çdo vit ushtrimor fillon në datën 1 Janar dhe mbaron në 31 Dhjetor. Llogarite vjetore, inventari dhe të dhënat mbi lëvizjet financiare të vitit, raportet speciale të ndërtuara nga administrator dhe ekspert kontabël, miratohen nga Asambleja e Përgjithshme. Miratimi i dokumentave mbi aktivitetin vjetor kryhen brenda një afati 6-mujore nga data e mbylljes së vitit ushtrimor. Mbas miratimit të llogarive vjetore dhe evidencës së të ardhurave Asambleja e Përgjithshme vendos pjesën që ju takon ortakëve në formën e dividend në të ardhura. Të ardhurat që ndahen mes ortakëve në bazë të pjesëve në kapitalin themeltar, përbëhet nga fitimi i vitit ushtrimor.

NENI 32 EKSPERT KONTABËL I AUTORIZUAR

Në rast nevojë ose nëse e kërkon ligji, kontrolli i shoqërisë kryhet nga eksperti kontabël i autorizuar dhe zgjedhur sipas ligjit në fuqi dhe statutit të kësaj shoqërie. Eksperti kontabël

emërohet çdo vit nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Eksperti kontabël mund të shkarkohet më përpara se afati i emerimit të tij, siç parashikohet në pikën dy të këtij neni nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë. Eksperti kontabel është i detyruar të zbatojë dispozitat ligjore dhe/ ose rregulloret në fuqi.

KREU V PRISHJA, LIKUIDIMI DHE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË NENI 33 SHKAQET E PRISHJES SË SHOQËRISË

1. Shoqëria priset: kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar; me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit; në rast se objekti bëhet i pareali-zueshem për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare; në rastet e pavlefshmerisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit "për shoqëritë tregtare" i ndryshuar; në raste të tjera, të parashikuara me ligj; për çdo shkak tjetër të vendosur nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve.
2. Prishja e shoqërisë, si pasojë e një apo me shumë prej shkaqeve të përcaktuara në shkronjat "a", "c", "d", "e" dhe "f", të pikës 1 të këtij neni, vendoset nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve me shumicën e cilësuar përcaktuar në këtë statut.
3. Në rast mosveprimi të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve për të vendosur prishjen, për shkaqet e përcaktuara pikën 2 të këtij neni, çdo person i interesuar mund në çdo kohë t'i drejtohet gjykatës kompetente për të konstatuar prishjen e shoqërisë.
4. Pavarësisht nga parashikimet e sipërpërmendura, ekzistenca e një a më shumë shkaqeve, të parashikuara në pikën 2 të këtij neni nuk do të ketë si pasojë prishjen e shoqërisë dhe hapjen e procedurave të likuidimit, nëse përpara vendimit gjyqësor të formës së prerë, të përmendur në pikën 3, të këtij neni, shkaku i prishjes është korrigjuar, nëse është e mundur të korrigjohet, dhe ky korrigjim është publikuar nga shoqëria në regjistrin tregtar, sipas parashikimeve të ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar.
5. Prishja e shoqërisë, si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "b" të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente për procedurat e falimentimit, kur, në përfundim të këtyre procedurave, të gjitha pasuritë e shoqërisë janë likuiduar për shlyerjen në mënyrë kolektive të detyrimeve ndaj kreditorëve apo kur gjykata kompetente për procedurat e falimentimit vendos rrezimin e kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit për shkak të pamjaftueshmërisë së pasurisë së shoqërisë për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit.
6. Prishja e shoqërisë si pasojë e shkaqeve të parashikuara në shkronjën "c", të pikës 1, të këtij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve të nenit 3/1 të ligji "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar.
7. Administratori/ët regjistrojnë prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit Nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Nëse prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve për regjistrim.

NENI 34 LIKUJDIMI DHE FALIMENTIMI



Likuidimi i shoqërisë bëhet sipas përcaktimeve të këtij statuti dhe sipas dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar. Falimentimi i shoqërisë bëhet në përputhje me përcaktimet e këtij statuti, ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjit Nr. 8901, datë 23.05.2002 “Për falimentimin” i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në fuqi për këtë qëllim. Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, sipas neneve 190 deri në 205 të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar.

ENI 35 RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Riorganizimi i shoqërisë mund të kryhet vetëm me vendim e Asamblesë së Përgjithshme dhe në përputhje me përcaktimet e këtij statuti si dhe me dispozitat ligjore në fuqi për këtë qëllim.

ENI 36 MOSMARRËVESHJET

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë kohës së likuidimit mes ortakëve, mes shoqërive dhe ortakëve fillimisht duhet të diskutohen për gjetjen e zgjidhjeve me mirëkuptim. Për zgjidhjen me mirëkuptim palët mund të hartojnë një akt-marrëveshje midis tyre. Palët për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mund ti drejtohen edhe ‘Ndërmjetësve Ligjore’ të licencuar në përputhje me ligjin në fuqi. Në rast se palët nuk gjejnë zgjidhje për mosmarrëveshjen e tyre sipas pikave të mësipërme atëherë ato mund ti drejtohen gjykave kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

THEMELUESIT SHOQËRIA “AGROTECH FARM” SH.P.K

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISË “IDEA - TEL” SH.P.K.

Z. Muhammed Sipi

(nënshkrimi)

ADMINISTRATORIT

Z. [Signature]

(nënshkrimi)

DATE 14 .09.2018.

Taksa e Pullës
u Pagua

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTER ARDIAN STAMO
PERSON FIZIK L617240350
NR. 1050. REP. 2

Tiranë më datë 19.09.2018

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot më datë 19.09.2018, para meje noterit të Dhomës së Notersë Tiranë, Noter Ardian STAMO, me zyrë të ndodhur në Tiranë, me adresë Rruga "Asim Vokshi", Pallati Nr. 141, u paraqit personalisht:-----

1. **Z. Muhamer ÇIPI**, i biri Ramadan dhe Shqipërije, lindur në Ersekë dhe me banim në Tiranë, me adresë banimi Njësia Administrative Nr. 9, Rruga "Mine Peza", i datëlindjes 28.10.1964, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik Nr. 032900954 dhe Nr.Personal: G41028107H, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar, me gjendje civile i martuar, edhe në cilësin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" SH.P.K. sipas ekstraktit të marrë pranë QKB-së bashkëlidhur.-----
2. **Z. Armand KAJA**, i biri i Zyhydi dhe Qefserë, lindur në Kavajë dhe me banim në Tiranë, me adresë banimi Yzberisht, Pallati "Jera CONSTRUCTION" Sh.p.k., ApNr. 3, Kati VIII, i datëlindjes 03.05.1973, i identifikuar nëpërmjet pasaportës biometrike Shqiptare Nr. BG6591156 dhe Nr.Personal: H30503221F, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe me gjendje civile beqar, në cilësin e administratorit të shoqërisë së re që do të krijohet "AGROTECH FARM" SH.P.K.-----

Të sipërpërmendurit u paraqitën përpara meje noterit duke deklaruar se jashtë kësaj zyre noteriale është hartuar akti i themelimit dhe statuti i shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K të cilën e nënshkruajnë në prani të noterit në çdo faqe personalisht, njëri në cilësin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" SH.P.K. tjetri në cilësin e administratorit të zgjedhur të shoqërisë së re që do të krijohet / regjistrohet "AGROTECH FARM" SH.P.K. Të sipërpërmendurit kërkuan nga unë noteri lëshimin e vërtetimit të nënshkrimit sipas dhe në përputhje me ligjin Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" i ndryshuar.-----

Z. Muhamer Çipi

Z. Armand Kaja

(KËRKUES)

(KËRKUES)

Në përputhje me ligjin Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterin" i ndryshuar unë Noteri Ardian GJ. STAMO lëshoj këtë vërtetim nënshkrimi sipas ligjit në fuqi duke vërtetuar se dokumentet statuti dh akti i themelimit të shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K. nënshkruhen para meje noterit Z. Muhamer ÇIPI i identifikuar si më sipër dhe në cilësin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA - TEL" Sh.p.k. dhe nga Z. Armand Kaja në cilësin e administratorit të zgjedhur të shoqërisë së re që do të krijohet e do të regjistrohet "AGROTECH FARM" SH.P.K. Ky vërteim nënshkrimi i bashkëlidhet aktit të nënshkruar nga kërkuesi në prani të noterit-----

NOTER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERISË TIRANË
NOTER ARDIAN GJ. STAMO
PERSON FIZIK L617240350

NR. 1051 . REP.

NR. 705 . KOL. 9



Tiranë më datë 19.09.2018

PROKURË E POSAÇME PËRFAQËSIMI

Sot më datë 19.09.2018, para meje Noterit të Dhomës së Notersë Tiranë, Noter Ardian GJ. STAMO, me zyrë të ndodhur në Tiranë, me adresë Rruga “Asim VOKSHI”, Pallati Nr. 141, u paraqit personalisht:-----

- Shoqëria “IDEA – TEL” SH.P.K. shoqëri me status aktiv, shoqëri e identifikuar nëpërmjet NIPT: J72902830L, shoqërie e krijuar që më datë 11.12.1997, shoqëri e regjistruar pranë QKB –së, shoqëri me status aktiv, shoqëri me seli të ndodhur në Tiranë, Rruga “Dritan Hoxha”, Ndërtesa Nr. 203, Hyrja Nr. 7, Apartamenti Nr. 27, shoqëri e cila përfaqësohet nga administratori i saj **Z. Genci MESI**, i biri i Sali dhe Nazmije, lindur në CUDHI Qendër Krujë dhe me banim në Tiranë, Njësia Administrative Nr. 3, Rruga “Qemal STAFA”, Nr. 343 6 12, i datëlindjes 16.07.1979, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik Nr. 024527440 dhe Nr.Personal: H90716017I, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar.-----

I sipërpërmendurit në cilësinë e administratorit të shoqërisë “Idea – Tel” Sh.p.k. bazuar në vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë “Idea – Tel” Sh.p.k. datë 19.09.2018, bazuar në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, bazuar në ligjin Nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për Noterinë” i ndryshuar, kërkoi nga unë noteri hartimin e prokurës së përfaqësimit si më poshtë vijon.-----

Unë Z. Genci MESI dhe në cilësinë e administratorit të shoqërisë “Idea – Tel” Sh.p.k. deklaroj para noterit se emëroj përfaqësues të posaçëm **Z. Armand KAJA**, i biri i Zyhydi dhe Qefsere, lindur në Kavajë dhe me banim në Tiranë, me adresë banimi Yzberisht, Pallati “Jera CONSTRUCTION” Sh.p.k., ApNr. 3, Kati VIII, i datëlindjes 03.05.1973, i identifikuar nëpërmjet pasaportës biometrike Shqiptare Nr. BG6591156 dhe Nr.Personal: H30503221F, madhor dhe me zotësi të plotë për të vepruar dhe me gjendje civile beqar, të cilit i jap tagre dhe kompetenca si më poshtë vijon:-----

1. Përfaqësuesi ka të drejtë të paraqitet para Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për të regjistruar shoqërinë “AGROTECH FARM” SH.P.K sipas dhe në përputhje me legjislacionin shqiptarë në fuqi për këtë qëllim bazuar edhe në vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë “Idea – Tel” Sh.p.k. si dhe në aktete e përkatitura dhe të nënshkruara të tilla si statuti dhe akt themelimi i shoqërisë “AGROTECH FARM” SH.P.K.-----
2. Përfaqësuesi ka të drejtë dhe kompetencë që për qëllim të regjistrimit të shoqërisë “AGROTECH FARM” SH.P.K të nënshkruaj në emër dhe për llogari time të gjitha




formularët e nevojshëm pranë QKB si dhe të kryej të gjitha pagesat e nevojshme dhe të kërkuara sipas ligjit në fuqi.-----

3. Përfaqësuesi ka të drejtë dhe kompetencë të tërheq nga QKB niptin si dhe ekstraktin e regjistrimit të shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K si dhe të bëj të gjitha njoftimet e nevojshme dhe të detyruara për hapjen e këtij subjekti, si por jo vetëm pranë administratës tatimore qendrore si dhe vendore në cilësinë e tij të përzgjedhur si administrator i shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K.-----
4. Përfaqësuesi ka të drejtë dhe kompetencë që të parqes pranë QKB çdo informacion, dokumentacion apo çdo akt tjetër të nevojshëm që kërkohet nga ky institucion me qëllim regjistrimin e shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K si subjekt juridik bazuar në legjislacionin shqiptarë në fuqi.-----
5. Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi sipas dhe në përputhje me tagret e dhënë sipas kësaj prokure do ti quaj të drejta dhe të mirëqena sikur të ishin kryer nga ana ime personalisht.-----
6. Kjo prokurë jepet pa afat deri në realizimin e tagreve dhënë më sipër.-----
7. Kjo prokurë përfundon me regjistrimin e shoqërisë "AGROTECH FARM" SH.P.K pranë QKB-së sipas dhe në përputhje me vendimin e ortakut të vetëm të shoqërisë "IDEA – TEL" Sh.p.k. me statutin dhe aktin e themelimit të nënshkruar nga oratku i vetëm is dhe nga administratori i emëruar dhe përzgjedhur, si dhe sipas ligjit në fuqi për këtë qëllim.-----

Kjo prokurë e posaçme u redaktua në bazë të vullnetit të lirë e të pavesuar të prokurdhënësit si dhe në mbështetje të nenit 64 të Kodit Civil si dhe ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" i ndryshuar, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar si dhe Ligjit Nr. 9723 dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" i ndryshuar. Kjo prokurë në bazë të nenit 51 të ligjit Nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për Noterinë" i ndryshuar, hartohet në katër kopje origjinale, në dy faqe, nga të cilat një kopje qëndron pranë kësaj zyre noteriale dhe kopjet origjinale i jepen prokurdhënësit. Për sa më sipër kjo prokurë Ju lexua prokurdhënësit me zë të lartë dhe të qartë, i cili shprehet se kuptoi përmbajtjen e kësaj prokure dhe meqënëse kjo prokurë është e njëjtë me vullnetin dhe dëshirën e tij firmoset pa asnjë vërejtje dhe/ose pretendim nga ana e tij në prani të noterit në çdo faqe. Unë noteri pasi konstatova se akti është në përputhje me vullnetin e tyre si dhe me ligjin në fuqi e nënshkruaj rregullisht këtë akt noterial.-----

NOTER



PROKURDHËNËSI

Genç Mesri

